



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.12.2019, ora 14:00

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i vendimit për propozimin Kuvendit “Për lirimin e një anëtari caktuar kryetar të Këshillit Drehtues të AKEP-it” (*Komision përgjegjës*)
2. Shqyrtimi i vendimit për propozimin Kuvendit “Për emërimin e një anëtari të Këshillit Drehtues të AKEP-it” (*Komision përgjegjës*)
3. Seancë dëgjimore me kandidaturën për anëtar të Këshillit Drehtues të AKEP-it” (*Komision përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Halil Jakimi, Besnik Baraj, Andrea Marto, Arben Pëllumbi, Gjetan Gjetani, Rrahman Rraja, Eglantina Gjermani, Tatiana Nurçe, Ilir Ndraxhi, Dritan Bici, Arlind Çaçani, Halit Valteri, Robert Bitri, Kujtim Gjuzi, Klajdi Qama, Zef Shtjefni, Fadil Nasufi dhe Edlira Hyseni.

Mungojnë:

Ilir Beqaj, Lefter Koka dhe Nimet Musaj.

Të ftuar:

Tomi Frashëri

Niko Peleshi –Mirëdita sërish,

Vazhdojmë mbledhjen e dytë të komisionit lidhur me Vendimin për propozim Kuvendit për lirimin e një anëtari të caktuar kryetar i Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

Relator është zoti Andrea Marto.

Fjala është për ju për t'i bërë të njohur Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese projektvendimin e qeverisë lidhur me lirimin e një anëtari të caktuar kryetar i Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare. Komisioni pasi njihet me projektvendimin e miraton ose jo. Më pas kemi edhe pikën tjetër, që ka të bëjë me projektvendimin e qeverisë për emërimin e një anëtari të Këshillit Drejtues të AKEP-it.

Konkretisht bëhet fjalë për zotin Tomi Frashëri, të cilin e falënderoj që ka ardhur në këtë dëgjese për t'u prezantuar dhe për t'u njohur me eksperiencën e tij jetësore, për të na lënë më pas mundësinë të gjykojmë nëse i plotëson apo jo kriteret e ligjit, për ta miratuar dhe për ta kaluar në votim në seancën plenare të Kuvendit.

Po, zoti Marto.

Andrea Marto - Faleminderit!

Siç jeni në dijeni nga dokumentacioni që keni përpara, zoti Ilir Zela kryetar i Këshillit Drejtues të AKEP-it dhe anëtar, i ka drejtuar zotit Ruçi kërkesën për dorëheqje. Kjo kërkesë është miratuar dhe në bazë të procedurave Kuvendi ka informuar qeverinë për këtë vakancë. Qeveria në bazë të ligjit i propozon Kuvendit lirimin e zotit Ilir Zela nga anëtar i caktuar në Këshillin Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare. Në vijim të saj në përputhje me ligjin, siç e thatë edhe ju, i propozon Kuvendit emërimin e zotit Tomi Frashëri anëtar të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

Duke parë dokumentacionin dhe duke e njohur zotin Frashëri, mund të them se ka një eksperiencë të denjë si në fushën akademike shkencore, por dhe në atë administrative. Shpreh bindjen time të plotë se mund ta realizojë me sukses këtë detyrë të rëndësishme, me të cilën është emëruar nga Këshilli i Ministrave.

Ftoj të gjithë kolegët që ta votojmë propozimin e paraqitur nga Këshilli i Ministrave.

Niko Peleshi – Po, zoti Gjuzi.

Kujtim Gjuzi - Faleminderit!

Zoti Frashëri, nëse më lejoni, kam një pyetje. Keni qenë prej sa vjetësh pranë Kryeministrit për t'u kujdesur për protokollin?

Niko Peleshi - Më falni zoti Frashri, përpara se të merrni fjalën ju për procedurë e ka kërkuar fjalën zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi – Besoj se për procedurë ne duhet të ecim me pranimin e lirimit të zotit Ilir Zela nga ajo detyrë dhe me dëgjuesën e zotit Frashëri për propozimin për këtë pozicion. Pasi të kemi bërë dëgjuesën, mund të vazhdojmë me pyetjet. Ka të drejtë çdo koleg edhe zoti Gjuzi, për të bërë pyetje. Pra, të ecim me një rregull të caktuar.

Niko Peleshi - Vërejtja qëndron.

Zoti Gjuzi erdhi pak me vonesë dhe ndoshta nuk e ndoqi axhendën, por kjo është radha e punës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju mirëkuptojmë.

Pasi jemi njohur nga relatori me vendimin e qeverisë lidhur me lirimin e një anëtari të AKEP-it i emëruar kryetar, konkretisht zotin Zela, kalojmë në votimin e projektvendimit. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet projektvendimi për lirimin nga detyra të zotit Zela.

Fjalën e ka zoti Tomi Frashëri, i cili është propozuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.778, datë 03.12.2019 “Për emërimin e anëtarit të Këshillit Drejtues të AKEP-it”.

Ju lutem, prezantohuni me CV-në dhe ambicien tuaj si anëtar i bordit.

Tomi Frashëri – Faleminderit, zoti kryetar!

Zonja dhe zotërinj anëtarë të komisionit, ju falënderoj që më jepni mundësinë të marr fjalën para jush!

Propozimin që Këshilli i Ministrave i ka paraqitur Kuvendit, për shqyrtim dhe gjykim e shikoj si një mundësi për të dhënë kontributin në kuadrin e një autoriteti rregullator të nivelit më të lartë, të nivelit kombëtar, i cili ushtron veprimtarinë e tij në një fushë gjithmonë e më shumë strategjike për të ardhmen.

Pas një formimi të plotë në Francë në të drejtën publike franceze me një qasje mjaft të theksuar nga e drejta publike ekonomike dhe nga shoqëria e informacionit, besoj se kam përftuar një përvojë jo të vogël në fushën e drejtësisë, duke punuar për një kohë relativisht të gjatë qoftë në botën universitare, qoftë në gjymtyrë të rëndësishme të administratës publike franceze. Prej 5 vjetësh më është mirëbesuar detyra e këshilltarit për koordinimin diplomatik dhe protokollar të Kryeministrit. Është një detyrë që në 5 vjet më ka dhënë dorë të përfitoj një eksperiencë të mirëfilltë në fushën e negocimit ndërkombëtar, por edhe në

trajtimin e situatave komplekse organizative dhe institucionale që janë paraqitur në këta 5 vjet. Në këtë kontekst të qenit anëtar i një këshilli drejtues, në këtë rast të AKEP-it është një sfidë e konsiderueshme dhe shumë stimuluese në të njëjtën kohë. Përballja me aspektet teknologjike dhe inxhinierike specifike të misionit të këtij autoriteti është e tillë që në vizionin tim zgjeron dimensionet e së drejtës në vetvete, të drejtave subjektive të qytetarëve dhe i kthen instrumentet në rregullatorë, në mekanizma potencialë dhe të zhvillimit të qëndrueshëm. Mendoj se AKEP-i e ka kapacitetin të zhdërvjelltësojë 3 misionet e tij kryesore që po i përmbledh: mbikëqyrjen e rrjetit; aksesin dhe përdorimin e tij; monitorimin e shfrytëzimit të burimeve, sidomos të atyre të kufizuara natyrore; si dhe kontrollin e tregut dhe konkurrencës eficiente, e cila vetëkuptohet që ka një impakt jo vetëm në zhvillimin ekonomik të vendit, por edhe në përditshmërinë e jetës së qytetarëve, pasi kondicionon në një masë të madhe dhe çmimet, mbi të gjitha cilësinë e shërbimit të rrjetit që i ofrohet qytetarit.

Fokusi i AKEP-it, siç e dimë mirë të gjithë është kryesisht rregullator, por AKEP-i është një organ vendimmarrës dhe duhet të ketë një qasje ekonomike, sociale, ndërlidhëse, dhe mirëqeverisëse.

AKEP-i ka shumë sfida që nga krijimi i tij, të cilat janë ende në rend të ditës, siç është zhvillimi dhe përmirësimi i infrastrukturës *broadband*. Ndoshta nuk është këtu vendi për të bërë një analizë të këtij sektori të një rëndësie kapitale. *Broadband*-i do të ketë impaktin e tij, ka filluar ta ketë tashmë, por do ta ketë edhe në vijim në ofrimin e shërbimeve publike që janë esenciale dhe për vazhdimësinë e tyre, qoftë në shëndetësi, edukim, apo në shërbimet administrative sa më pranë jetës së qytetarëve. Ekziston një plan kombëtar i *broadband*-it, i cili mund të ketë nevojë në vijim edhe të përmirësohet, sidomos duke pasur parasysh edhe nevojën e përputhshmërisë me rekomandimet e BE-së, por edhe me institucionet e tjera ndërkombëtare të rregullatorëve, në të cilat AKEP-i është palë. Ky plan i ka tashmë disa prioritete, të cilat lakohen në jetën e përditshme të qytetarëve me dyfishimin eventual të numrit të familjeve dhe të kompanive që duhet të kenë një lidhje të shpejtësisë së lartë *broadband*, 100%, të shkollave me klasa dhe mbi të gjitha me mjedise të përbashkëta me një lidhje *broadband*. E njëjta gjë vlen edhe për institucionet e arsimit të lartë dhe për qendrat shëndetësore. Një nënvizim, sepse AKEP-i mbulon zyrat postare, 100% e zyrave postare duhet të pajisen me lidhje *broadband*, pasi këto të fundit kanë një vokacion të shërbimit publik specifik dhe të jashtëzakonshëm, sepse sigurojnë në njëfarë mënyrë rrjetëzimin e territorit. Nëse mund të konsiderojmë që telefoni celular është pika

fundore e komunikimit për çdo individ me të ngjashmin e tij, zyra postare ka vokacionin që të kthehet në pikën fundore të komunikimit të një komuniteti të tërë që nga viset më periferike deri te periferitë e qyteteve të mëdha, ku ndoshta këto shërbime nuk janë ende të siguruara.

Kjo më lejon që të bëj një kalim në një pikë tjetër që e gjykoj të rëndësishme si mision të AKEP-it që është instaurimi i një shërbimi universal, i cili është sa një detyrë ligjore, po aq dhe një kërkesë e kohës. Sigurisht që mund të mos hyhet në detaje, për të thënë që nxit investimet në zonat më të thella, që kërkon vëmendje në zbutjen e barrierave administrative për zgjerimin e shpejtë të infrastrukturës në zona të thella dhe terren të thyer, por na ndërgjegjëson edhe për diçka tjetër me rëndësi që është nevoja për lehtësim në procedurat administrative për marrjen e lejeve dhe miratimin e tyre për operatorët që do të operojnë për shërbimin universal.

Besoj se ka shumë gjëra për të thënë, por nuk dua ta marr kohën tuaj. Do të ndalesha në 2 pika të tjera që mendoj si anëtar nëse më jepet besimi nga Kuvendi i Shqipërisë, duhet t'i promovoj në kuptimin e mirë të fjalës dhe të këmbëngul që AKEP-i t'i ketë në vëmendje të veçantë: është sfida e 5G që besoj se është sa një subjekt entuziazmi, por edhe shqetësimi global dhe qytetar, sepse ka impakt dhe në të dyja këto sfera. AKEP-i si organ rregullator duhet të ketë parasysh se roli i tij është i rëndësishëm. Së pari, ai duhet të lakohet në rivlerësimin dhe në përmirësimin e vetë kuadrit rregullator. Duhet pasur parasysh që monitorimi, kontrolli dhe minimizimi i krimit kibernetik janë synime emergjente ndërqeveritare, ndërshtetërore. AKEP-i duhet të ketë rolin e tij për luajtur, duket të përgatisë nëse është ende në fazën e ndërtimit të një dispozitivi të tillë duhet të disponojë një dispozitiv qoftë teknik, qoftë njerëzor, normativ për të përballuar sfidat që dalin si nga instalimi i 5G-së, ashtu dhe nga ekzistencat që ka siguria kibernetike. Në këtë rast AKEP-i duhet të investohet në një qasje bashkëpunuese dhe koordinuese edhe me autoritete e tjera, siç është Autoriteti i Certifikimit Elektronik dhe i Sigurisë Kibernetike. Duhet të ketë gjithashtu një bashkëpunim rajonal dhe ndërkombëtar goxha të zhdërvjellët në mënyrë që këto sfida të jenë të përballueshme në kuadrat më të gjëra se sa thjesht ai kombëtar. Në prill të vitit që vjen do të zhvillohet samiti dixhital në Shqipëri, i cili do të jetë një test shumë interesant për kapacitetet që AKEP-i do t'i sigurojë vetes, për të qenë në këtë aspekt një aktor aktiv, por edhe një rregullator edhe më i përgjegjshëm me kapacitete koordinimi të konsoliduara.

Në fund, mund të them diçka për çështjen e spektrit të radiofrekuencave, sepse kjo është deri diku dhe sfida klasike dhe një nga misionet klasike të AKEP-it. Të gjithë e dimë që është një burim i kufizuar natyror dhe kërkesa është e madhe, oferta është e limituar. Ka impakt të rëndësishëm në rritjen ekonomike dhe është sfida kryesore për rregullimin e tregut: hartimi i një plani të ri të frekuencave. Ekziston një plan kombëtar i frekuencave që nga viti 2013, në mos gaboj. Si çdo dokument meriton gjithmonë për përmirësime dhe për rishikime, sidomos duke pasur një qasje të integruar gjithmonë në sensin e një përputhshmërie sa më të madhe me rekomandimet e BE-së dhe të institucioneve të tjera ndërkombëtare të trupave rregullatore.

Pa dashur të marr më tepër nga koha juaj, duhet të keni dhe pyetje, të cilat do të kem nderin t'u përgjigjem.

Mendoj se kjo ishte pak a shumë ajo që një kandidat për anëtar në Këshillin Drejtues të AKEP-it mund të ushqejë modestisht si ambicie, pasi nuk do të jetë i vetëm në vendimmarrje dhe as në planifikimin e strategjive në çështjen e rregullimit të komunikimeve elektronike të sektorit postar, por mendoj se për sa më takon jam i qartë në sfida, jam i qartë në rolin e AKEP-it dhe në kapacitetet e tij, qofshin edhe potencialë në momentin që flasim, sepse është vërtet një autoritet, i cili ka mundësi dhe ka një dorë për të qenë aktiv në politikëbërje në kuptimin e mirë të fjalës. Sigurisht, nuk zëvendëson as ekzekutivin dhe as legjislativin, por është në krah të tyre dhe me aktivitetin e tij rregullator mund t'u japë një shtysë të gjitha sfidave për të konkretizuar në një mënyrë sa më të frytshme interesin e përgjithshëm, interesin shtetëror të Republikës së Shqipërisë, por edhe interesin e qytetarëve në jetën e tyre të përditshme, sepse e ka dhe këtë mision mbështetës të vijimësisë së shërbimeve publike.

Ju falënderoj dhe jam i gatshëm për çdo pyetje!

Niko Peleshi – Faleminderit, zoti Frashëri!

Ka pyetje?

Po, zoti Gjuzi.

Kujtim Gjuzi – Keni qenë këshilltar i Kryeministrit?

Zoti Këshilltar i Kryeministrit dhe njëkohësisht Drejtor i Protokollit apo jo, që nga data 9.09.2014, pyetja ime është e drejtpërdrejtë për ju: pse është dëmtuar protokollin i shtetit në vizitën e Papës në Tiranë në Rinas rreth orës 13:30 kur Kryeministri aty ka marrë familjen e tij dhe djalën e tij ia ka vënë në prehër Papës? A keni dijeni për këtë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Ju lutem, qëndroni brenda tematikës!

Kujtim Gjuzi – Një sekondë! Diku do të dal, si mendon se nuk dal dot unë? Ja ku jam, kam ardhur në parlament, nuk e ke parë në ëndërr se mund të vinte Partia Konservatore.

Pyetja e dytë, ju jeni prej 6 vjetësh e ca pranë Kryeministrit, a po shkoni për të kontrolluar, për të informuar dhe për të këshilluar Kryeministrin në lidhje me mediet? Nëse po, cila do të ishte këshilla juaj? Që Kryeministri t'i qëndrojë pak larg medieeve, të mos i kontrollojë më, apo të vazhdojë t'i kontrollojë deri në themel?

Niko Peleshi - Po, zoti Shtjefni.

Zef Shtjefni - Kam një pyetje. E kam thënë edhe në fjalën time në parlament, por meqenëse zotëria do të shkojë anëtar tek AKEP-i, shpresoj të shkojë, sepse votat i keni, atje ka një shqetësim të madh: çfarë përgjegjësie do të ketë AKEP-i për vjedhjen që u bëhet shqiptarëve te Vodafone, Albtelekom-i, tek Eaglemobile në ofertën e internetit. Është një skandal.

Niko Peleshi - Ka pyetje të tjera?

Po, zonja Gjermani.

Eglantina Gjermani - E para, dua të falënderoj zotin Frashëri për prezantimin goxha përfshirës edhe për të gjithë punën e AKEP-it duke e gërshtuar edhe me përvojën e tij jetësore!

Dua të theksoj faktin që ne si parlament dhe si komision, shikojmë çdo vit raportin e AKEP-it dhe përgatisim një rezolutë me detyrat për vitin që vjen. Është një program shumë i mirë pune për vazhdimësinë e AKEP-it, prandaj bashkëpunimi mes nesh dhe AKEP-it është i vazhdueshëm dhe do të kemi mundësi të jemi në kontakt në vazhdimësi, duke uruar që të zgjidheni në këtë detyrë.

Detyrat që keni mbajtur deri tani kanë pasur goxha përgjegjësi dhe kompleksitet. Ju e përmendët pak. Mendoj se disa aftësi që keni përdorur aty, mund t'i përdorni shumë mirë edhe tek AKEP-i, kur bëhet fjalë për integritet, kur bëhet fjalë për të punuar nën presion dhe kur bëhet fjalë për punën në grup, si dhe elemente të tjera. Cila mendoni se duhet të jetë gjëja më e rëndësishme që keni fituar nga përvoja juaj deri tani, që do t'ju ndihmojë ta bëni me sukses detyrën tek AKEP-i?

Niko Peleshi - Po, zoti Bici.

Dritan Bici – Duke parë CV-në tuja krijoj bindjen që jeni jo për anëtar të Këshillit Drejtues të AKEP-it, por më tepër. Roli i anëtarit është shumë pak me përgatitjen tuaj. Kam

një pyetje: në një nga pikat shpreheni se keni punuar në administratën publike franceze, cila ka qenë arsyeja e largimit nga detyra që keni pasur? Nëse mund të na e thoni.

Niko Peleshi – Po, zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit zoti Frashëri për të gjithë prezantimin që i bëtë CV-së suaj, por edhe vizionit që keni për të ardhmen e AKEP-it!

Ndoshta nuk kam një pyetje të drejtpërdrejtë, por dua të bëj një koment, duke pasur parasysh faktin që jeni shkolluar dhe keni filluar një aktivitet në një vend lider të BE-së, por e keni lënë atë pozicion dhe jeni kthyer në atdhe, që unë e shikoj si një gjë shumë pozitive, duke marrë shtysë nga kjo gjë, do të doja që përpara këtij mikrofoni t'i bëja thirrje një pjese të madhe të rinjve tanë të shkolluar jashtë, që ashtu si ju të kthehen për të dhënë kontributet e tyre në vendin tonë, kontribute për të cilat ne kemi shumë nevojë.

Nga ana tjetër, kam parasysh që në 5 vjet që keni qenë këshilltar diplomatik qeveria shqiptare ka pasur një arritje në arenën ndërkombëtare. Marr shkas pikërisht nga fakti që ne këto ditë marrim edhe drejtimin e OSBE-së. Mendoj se një meritë, sado të vogël, duhet ta keni edhe ju në këtë aspekt, krahas të gjithë faktorëve dhe aktorëve të tjerë. Sikurse e tha edhe zonja Gjermani, jam i bindur se kjo eksperiencë dhe ky kontribut, do të japin në mënyrë të padiskutuar rezultatet e veta edhe në arritjen e disa sfidave, që ju me të drejtë i përmendët për të ardhmen e AKEP-it.

Ne shpresojmë shumë që kjo eksperiencë dhe ato që dëgjuam nga ju të fillojnë të vihen pak nga pak në zbatim për të përballuar me një forcë, ndoshta më të madhe, edhe me mbështetjen e këtij komisioni, si komision përgjegjës për atë ent rregullator, sfidat që e presin dhe kryesisht atë që përmendët ju, që është sfida e së ardhmes, teknologjia 5G.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Ka pyetje të tjera?

Nëse nuk ka, zoti Frashëri, ju lutem, jepni një përgjigje për secilën nga pyetjet!

Tomi Frashëri – Faleminderit, zoti kryetar!

Ju falënderoj për pyetjet!

Për dy pyetjet e para është pak komplekse për t'u përgjigju.

E para, protokolli është një sistem rregullash, i cili ka për qëllim të sigurojë mirëtrajtimin, komoditetin dhe rangun e gjithsecilit nga pikëpamja ceremoniale, sepse ka edhe disa aspekte të tjera, të cilat nuk është e nevojshme të lakohen këtu. Si çdo sistem rregullash, edhe protokolli ndjek parimin juridik relativisht absolut, nëse mund ta them

kështu, që çfarë nuk është e ndaluar, është e lejuar. Në ceremonialin e Republikës së Shqipërisë nuk ka diçka që të ndalojë në një pritje të caktuar, e cila ka qenë e negociuar me autoritetet e Selisë së Shenjtë në atë kohë, pa hyrë në detaje, sepse çdo gjë negociohet në protokoll, për të gjetur një emërues të përbashkët, që të gjithë të jenë komod dhe të kënaqur. Nuk ka asgjë që të ndalojë mikpritjen shqiptare tradicionale në këto raste, ku përfshihen edhe anëtarët e familjes, duke pasur parasysh që ceremoniali i Republikës, sidomos në vitin 2014, pasi ka pasur një modifikim të lehtë në vitin 2016, i jepte një rol, që ia jep ende sot, bashkëshortes së Kryeministrit, fëmijëve të Kryeministrit, të Presidentit të Republikës dhe të Kryetarit të Kuvendit. Shpresoj që me këtë përgjigje ta kem ezauruar pyetjen tuaj.

E dyta, për medien gjërat janë të ndara. Unë kam siguruar dhe vazhdoj të siguroj, për aq kohë sa do të jem në Kryeministri, këshillimin e Kryeministrit për çështje që kanë të bëjnë me drejtimin diplomatik, me protokollin dhe me ceremonialin e Kryeministrit. Nuk kam të bëj me medien, nuk është fusha në të cilën më është mirëbesuar ndonjë kompetencë apo ndonjë tagër për t'u marrë apo për të folur, ndaj, me gjithë dëshirën e mirë, e kam të vështirë t'ju jap një përgjigje shteruese për pyetjen tuaj.

Sigurisht, jam këshilltar i Kryeministrit, kam një respekt dhe një admirim të veçantë për punën e tij, sepse unë e shikoj në përditshmëri si punon Kryeministri, më pas gjithsecili nga ne dhe nga ju, që jeni ligjvënës dhe kontrollues të qeverisë, gjykon se sa mirë është kryer puna. Kam admirim dhe respekt për të! Është një shembull për mua, sidomos në situata presioni, kur duhet pasur angazhim personal deri në fund dhe deri në detaj për të qenurit në protokoll, detaji është element kapital në shërbim të çështjes publike, cilado qoftë ajo, nga momenti që ka marrë miratimin e zgjedhësit në zgjedhjet e përgjithshme. Këtë mund të them për sa i takon pyetjes suaj të dytë.

Çështja e operatorëve, e internetit, e ofertës, e shërbimeve për qytetarët dhe pakënaqësitë që mund të kenë ngjallur në të kaluarën situatat që ju përshkruat, zoti deputet, është diçka, për të cilën unë duatë mësoj më tepër dhe të vihem në situatë për të kuptuar rrënjët e problemit, e të gjitha me radhë, në mënyrë që duke qenë pjesë e Këshillit Drejtues të AKEP-it, të mund të gjejmë një zgjidhje, nëse problemi është i tillë, që e kërkon.

Për sa i përket rolit të AKEP-it në ofrimin e shërbimeve të rrjetit dhe të internetit, sigurisht që ligji është mjaft i qartë dhe konciz për rolin e tij rregullator. Për sa u takon autorizimeve që jep, individuale apo të përgjithshme, si për rolin që ka në përcaktimin e tarifave, si për misionet mbikëqyrëse, monitoruese, kontrolluese, si dhe masat që merr në

kuadër të misionëve kontrolluese, masa që kanë të bëjnë me kundërvajtje apo masa të rënda financiare. Ligji besoj se i shteron shumë të gjitha këto.

Edhe një herë, do të dëshiroja t'ju jepja një përgjigje më të saktë, por për momentin më duhet edhe mua të përftoj të gjithë njohurinë e duhur dhe përmbajtjen e kësaj dosjeje. Me siguri kjo është në dorën tuaj nëse e miratoni kandidaturën time, që të më thërrisni për dëgjues në çdo moment. AKEP-i dhe besoj secili nga anëtarët e Këshillit Drejtues, por edhe Këshilli Drejtues në tërësinë e tij është në dispozicion të përfaqësues kombëtare. Në këtë aspekt do të jem gjithmonë i gatshëm për t'ju përgjigjur me detaje pyetjeve.

Për sa i përket kthimit tim në Shqipëri, unë kam punuar 4 vjet te Ombudsman--i francez, i cili pësoi një reformë. Autoriteti i parë i pavarur në Francë, i krijuar në vitin 1973, në vitin 2008 pësoi një reformë rrënjësore, pasojë e një reforme kushtetuese në Francë, duke përthithur institucione që shkonin nga deontologjia e sigurisë deri te komisionet e larta kundër diskriminimit. Po evitoj të përmend disa komisione të tjera, që nuk janë relevante për këtu, duke marrë një peshë shumë të madhe për sa i përket të gjithë mediacionit të shërbimeve publike dhe të lirive themelore të qytetarëve. Ka një rol shumë më të madh, shumë më me peshë se Avokati i Popullit në vendin tonë, si dhe institucione të ngjashme në vende të tjera, sepse pushteti kushtetues në Francë donte t'ia njihte këtë fuqi.

Eksperienca që kam përftuar atje ka qenë e jashtëzakonshme. Dosjet ishin të një larmie shumë të madhe. Themelore në atë institucion ishte gjithmonë kontakti me qytetarin dhe përgjigjja e detyruar që duhej t'i jepej atij bashkë me orientimet përkatëse në rast se mediatori nuk arrinte vetë të kishte bindjen se duhej ndërhyrë dhe duhej sanksionuar administrata për një çështje të caktuar.

U ktheva, për arsye të një situatë familjare, e cila u kombinua shumë rastësisht me një seminar që kam bërë me ftesë në Ministrinë e Jashtme, thjesht për protokollin dhe ceremonialin. U kontaktova nga zyra e Kryeministrit, e cila në atë moment kërkonte të plotësonte ekipin e vetë të ceremonialit, duke pasur parasysh që Kryeministri, si shef i pushtetit ekzekutiv, ka një gamë jashtëzakonisht të gjerë veprimtarish, por edhe trajtimi situatash, qofshin këto përmbajtjesore apo organizative, me një nivel shumë të lartë urgjence në përditshmëri. Për këtë arsye, u kombinuan të dyja situatat, ajo familjare dhe profesionale, e them në mënyrë shumë njerëzore këtë. Duke qenë i pamartuar në atë kohë, mendova se ishte momenti për një “aventurë”, në sensin e mirë të fjalës, megjithëse isha shumë mirë i stabilizuar në Francë, për të bërë aventurën e fundit para krijimit të familjes me synim për t'i shërbyer edhe vendit, për të dhënë kontributin tim për vendin, qoftë ky kontribut i limituar në

kohë apo përgjithmonë. Zoti deshi që më vonë krijova edhe familjen në Shqipëri. Ky është kuptimi, të cilin po e them në mënyrë njerëzore dhe shumë të hapur. Për këto arsye gjendem ende këtu.

Pyetja e zonjës Gjermani është shumë me vlerë, të cilën e bëjnë gjithmonë jashtë vendit, të paktën në rekrutim: çfarë ke përftuar nga përvoja e mëparshme që bën të kesh një lloj bindjeje se mund t'ia dalësh në misionin pasardhës? Mendoj se diçka shumë e rëndësishme, që ne na mungon, që është e padukshme, gati e dematerializuar, është sensi i përulësisë. Përulësia përballë detyrës që ke, përballë asaj çfarë është përtej detyrës, sepse detyra është pjesa që ti realizon, por në shërbim të kujt zhvillohet dhe kryhet ajo detyrë, është diçka që secili duhet ta ketë parasysh. Përulësia, në raport me detyrën, të bën të përulur, jo “të poshtëruar”. Kjo ngatërrohet shumë shpesh, të përulur në raport edhe me ekipet që ke në varësi, të cilët janë, së pari, bashkëpunëtorë, sepse asgjë nuk mund të bëhet pa ata, dhe, së dyti, sepse detyra është më lartë se funksioni që na është mirëbesuar, sepse jo çdo gjë për detyrën, pasi të gjithë jemi njerëz me ndërgjegje dhe e njohim ligjin, por gjithçka është e mundur dhe brenda kapaciteteve tona për t'iu përkushtuar detyrës. Përulësia formon ekip, përulësia i mban ambiciet legjitime në kufij të arsyeshëm, përulësia jep sensin e detajit, që është shumë i rëndësishëm dhe kurrë nuk duhet humbur nga sytë; përulësia krijon komunitet bashkëpunimi, i cili më pas jep frytet e veta.

Në rastin e AKEP-it, për sa më takon, do të jem më i përulur se kurrë, sepse, megjithëse tezën e masterit të shkencave në Francë e kam mbrojtur pak a shumë në këtë spektër, gjithsesi nuk jam marrë në mënyrë të drejtpërdrejtë me këtë subjekt, edhe pse e kam ndjekur nga larg, dhe kam më shumë se një të drejtë për të qenë i përulur dhe për të përftuar sa më shumë, duke marrë detyrën, që më pas të mundohem ta zbatoj sa më konform ligjit dhe pritshmërive.

Niko Peleshi – Faleminderit, zoti Frashëri!

Ka një koment nga zoti Gjuzi dhe më pas do të vazhdojmë me procedurën.

Kujtim Gjuzi – Faleminderit, kryetar!

Së pari, dëshiroj të falënderoj pas kësaj ekspozije ekselence, do ta quaja. Përfitoj nga rasti ta quaj koleg, sepse kur vijnë këtu mbiemra të mirë, unë jam i gatshëm t'ua jap votën pro. Ju e fitoni votën time në këtë moment, që është e vështirë ta marrësh, sepse kryesisht abstenoj.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Zoti Bici.

Dritan Bici – Faleminderit, kryetar!

Edhe unë, si parafolësi, duke dëgjuar prezantimin që bëri zoti Frashëri për kandidaturën në Këshillin Drejtues të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, mendoj se e meriton dhe e supermeriton atë vend. Ndoshta duhet të jetë edhe kryetar i këtij autoriteti.

Ai dëshmoi një përgatitje tepër të lartë për të qenë në këtë vend, por më shumë nga të gjitha më pëlqeu përlësia para detyrës, që shumë nga drejtuesit tanë e shpërfillin ose nuk e kanë fare, sepse shkojnë në një vend të emëruar nga partia, nga Kuvendi apo nga Kryeministri, dhe është shumë e vështirë t'u trokasësh në derë apo t'u drejtohesh për ndonjë problem.

Personalisht, mendoj se ky është personi që i duhet administratës sonë shtetërore.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Faleminderit!

Për etikë, normalisht duhet t'i kërkoja zotit Frashëri të na jepte kohë për të diskutuar, por duke parë edhe frymën tuaj, nisur edhe nga prezantimi i tij, besoj se mund të kalojmë direkt në votimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 778, datë 03.12.2019 për propozimin Kuvendit “Për emërimin e një anëtar i Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare” për zotin Tomi Frashëri.

Ne duhet të shprehim dakordësinë tonë me votë ose jo për plotësimin e kriterëve. Të gjithë ju keni përpara relacionin dhe jeni të informuar për kërkesat e ligjit. Në referencë edhe të CV-së, po jap opinionin personal. Zoti Frashëri e plotëson kriterin e 10 vjetëve eksperiencë, është i diplomuar për Drejtësi, konkretisht në një nga fushat e lejuara për të qenë anëtar i Bordit; ka një eksperiencë të pasur dhe prezantimi i tij ishte shumë dinjitoz dhe bindës. Personalisht, ju ftoj ta miratojmë konformitetin me kërkesat e ligjit të kandidaturës së zotit Frashëri.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Ju uroj fat, zoti Frashëri, edhe në seancën plenare!

Tomi Frashëri - Faleminderit për durimin dhe mirëbesimin tuaj!

MBYLLET MBLEDHJA